

KËRKESË PËR INFORMACION

--	--	--

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

1. A është Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare kompetent për pezullimin ose çaktivizimin e domain-it zyrtar të një subjekti tregtar, në rast se ky subjekt ofron shërbime pa licencë të vlefshme?

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) administron domain-in kombëtar “.al”, në përputhje me shkronjën dh) të pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregulloren nr. 2, datë 21.02.2008, “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën “.al””, e ndryshuar.

Sipas shkronjës c) të pikës 2 të nenit 3 të ligjit nr. 54/2024, AKEP nuk ka kompetencë ligjore për të shqyrtuar përmbajtjen e faqeve të internetit apo shërbimet e ofruara përmes tyre, dhe rrjedhimisht nuk merr vendime mbi përmbajtjen apo ligjshmërinë e shërbimeve online.

AKEP mund të ndërmarrë masa për bllokimin ose çaktivizimin e një domain-i “.al” vetëm në rastet kur kjo kërkohet zyrtarisht nga institucionet kompetente të përcaktuara me ligj, përfshirë organet e ndjekjes penale, ose në bazë të një vendimi gjykatë.

Në lidhje me pyetjen tuaj, AKEP nuk është kompetent për pezullimin ose çaktivizimin e domain-it zyrtar të një subjekti tregtar vetëm për faktin se ky subjekt ofron shërbime pa licencë të vlefshme. Ofrimi i shërbimeve pa licencë përbën shkelle të regjimit të autorizimit/licencimit dhe trajtohet me masa administrative specifike, sipas legjislacionit përkatës, por nuk përbën shkak automatik për çaktivizimin e domain-it.

Pezullimi ose çaktivizimi i një domain-i lejohet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga legjislacioni në fuqi dhe rregullorja e domaineve “.al”, dhe jo si masë e përgjithshme sanksionuese për mungesë licence.

2. Në rast se një shoqëri ajrore ka licencën e operimit të pezulluar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, por vijon të shesë bileta përmes faqes zyrtare online, a përbën kjo bazë ligjore për ndërhyrje nga AKEP?

Për sa i përket pezullimit apo çaktivizimit të domainit të kësaj shoqërie, AKEP mund të ndërhyjë vetëm me marrjen e një kërkesë zyrtare nga institucionet kompetente të përcaktuara me ligj.

3. A ka marrë AKEP ndonjë kërkesë nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose nga ndonjë institucion tjetër shtetëror lidhur me domain-in e shoqërisë Air Albania?

Jo. Domain-i airalbania.com.al është i regjistruar dhe aktiv në sistemin e administrimit të domaineve “.al”, i regjistruar sipas një procedure të rregullt dhe në përputhje me Rregulloren nr. 2, datë 21.02.2008, “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën “.al”, e ndryshuar.

Në përputhje me shkronjën b) të pikës 6.3 të nenit 6 të kësaj rregulloreje, domain-et nën “.com.al” mund të regjistrohen nga persona juridikë privatë. Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti posedues i këtij domain-i ka status “aktiv” pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Për rrjedhojë, në kuadër të legjislacionit dhe rregullave në fuqi për administrimin e domaineve “.al”, regjistrimi i domain-it airalbania.com.al është legjitim.

4. A është shqyrtuar nga AKEP aktiviteti online i Air Albania pas pezullimit të licencës së saj nga AAC? Nëse po, cilat kanë qenë gjetjet?

Jo. Siç është sqaruar më sipër, AKEP nuk ka kompetencë ligjore për të shqyrtuar përmbajtjen e faqeve të internetit apo shërbimet e ofruara përmes tyre.

5. Cilat janë procedurat që ndiqen për pezullimin e një domain-i .al për arsye të mbrojtjes së konsumatorit ose parandalimit të mashtrimit?

Për shkak të natyrës së kompetencave të tij ligjore, AKEP nuk shqyrton dhe nuk ndërhyr në përmbajtjen e faqeve të internetit, por vepron ekskluzivisht në nivel teknik dhe administrativ të domain-it, mbi bazën e një kërkesë të ligjshme nga institucioni kompetent ose në zbatim të një vendimi gjyqësor.

Pezullimi ose kufizimi i aksesit në një domain “.al” për arsye të mbrojtjes së konsumatorit ose parandalimit të mashtrimit nuk kryhet drejtpërdrejt nga AKEP, por ndiqet një procedurë bashkëpunimi ndër-institucional, në përputhje me kompetencat ligjore përkatëse.

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: Përmes postës elektronike

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: _/_/20_	Numri rendor i kërkesës:	Komente: _____ _____ _____
-------------------------	--------------------------	----------------------------------

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.